

URDHËR
Nr.528, datë 25.10.2011

PËR TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR TË GJITHA PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, MË KOHË TË PJESSHME E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, PËR VITIN AKADEMIK 2011-2012

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, si dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” dhe pikës 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.627, datë 31.8.2011 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2011-2012”,

URDHËROJMË:

1. Tarifa për kreditë e shkollimit, për ata që kryejnë një program të parë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë, të jetë sipas kolonës F të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Tarifa totale e shkollimit (180 kredite), për ata që kryejnë një program të parë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë të jetë sipas kolonës G të tabelës nr.1 bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Tarifa për kreditë e shkollimit, për ata që kryejnë një program të dytë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë të jetë sipas kolonës H të tabelës nr.1.

4. Tarifa totale e shkollimit (180 kredite), për ata që kryejnë një program të dytë studimi, për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë të jetë sipas kolonës I të tabelës nr.1.

5. Tarifa e shkollimit paguhet me këste vjetore, çdo fillim viti akademik, të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në rregulloret e tyre.

6. Studentët e shpallur jokalues/përsëritës, paguajnë tarifë shkollimi, në vitin përsëritës, vetëm për kreditet e provimeve të mbartura.

7. Kandidatët që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012 dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personave që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë, invalidë, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve dhe ushtarakëve të rënë për shkak të detyrës e të ish-të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

8. Tarifat e shkollimit të llogaritura sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, paguhen pranë zyrave të “Postës Shqiptare”, për llogari të institucionit të arsimit të lartë publik

përkatës.

9. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode